



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:052488

Datë: 25.08.2023

Numri i dokumentit: 04617493

Ac.nr.7301/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Frosina Sylajmani dhe Besnik Bislimaj- anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, A. S. nga fshati Z., Komuna e F. të cilin e përfaqëson E. P., avokat nga V., kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, të cilin përfaqësuesi i autorizuar Sami Vranovci, me objekt kontesti pagë jubilarë dhe shpenzimet e shujtës ditore, vlera e kontestit 1.436.68 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.696/20, të datës 13.04.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur më **24.08.2023** mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA THEMELTË ankesa e të paditurës, Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.696/20, e datës 13.04.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.696/20, të datës 13.04.2021 ka gjykuar si në vijim:

I. APROVOHET si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësit A. S. nga fshati Z., Komuna e F. dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë që paditësit t'ia paguaj në emër të pagës jubilarë shumë prej 120.86 euro, 50 % të pagës bazë (241.68 euro) për 10 vite përvojë pune në emër të shpenzimeve të ushqimit-shujtës ditore shumë prej 1.316 euro për 658 ditë të pranisë në punë (për çdo ditë nga 2 euro), të gjitha së bashku në shumë prej 1.436,68 euro me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 14.05.2020

e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 104 euro për përpilimin e padisë, 80 euro në emër të precizit të kërkesëpadisë, shumën prej 135 euro për një seancë gjyqësore dhe taksën gjyqësore në vlerë prej 21, të gjitha në shumën e përgjithshme prej 340 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

III. REFUZHET kërkesëpadia për kompensimin e shpenzimeve të procedurës përtej shumës së gjykuar në shumën prej 193.8 euro dhe atë për kërkesën e dërguar degës për arsim 80 euro dhe ankesën e parashtruar degës për arsim 80 euro dhe shumën prej 33.08 euro për mungesë nga zyra 25% nga seanca si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë Aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë apo çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Pala paditëse nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195, par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës, Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Arsim dhe Kulturë është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, me datën 14.05.2020, ka ushtruar padi, ndërsa në seancën e datës 12.04.2021, ka precizuar kërkesëpadinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 120.84 euro në emër të shpërblimit jubilar për 50% të një page bazë, dhe shumën prej 1,316.00 euro në emër të kompensimit të shpenzimeve për shujtë ditore për 658 ditë të pranisë në punë për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me 22.04.2020, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës ka ushtruar përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se Komuna e Ferizajt nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkrues të Kontratës së lartcekur janë MASHT-i, dhe SBASHK-u andaj Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nuk prodhon efekte juridike për të paditurën ku sipas nenit 46 paragrafi 2 të Kontratës kolektive është

përcaktuar se nëse nuk ekziston mundësia financiare si një prej elementeve qenësore të Kontratës Kolektive nuk do të mund të përmbushen obligimet të cilat dalin nga kontrata.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit dhe shqyrtimit të provave si vërtetimin e datës 14.11.2019 të lëshuar nga SHFMU “4 Prilli” për mbi përvojën e punës për paditësin, Listën e pagës të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës në emër të paditësit, vërtetimin e datës 06.11.2020 lëshuar nga SHFMU “4 Prilli” për ditët e pranisë në punë për paditësin, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është mësimdhënës në SH.F.M. U “4 Prilli” në fshatin Zllatar Komuna e Ferizajt e po ashtu nuk është kontestuese as përvoja e punës prej 14 vite, dhe se paga bazë e paditësit është 241 euro. Poashtu, nuk është kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse lartësia e kërkesës për shujtat ditore nga 2 euro në ditë, për ditët e pranisë në punë edhe atë për 658 ditë, respektivisht kërkesa në lartësi prej 1,316.00 euro për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 22.04.2020. Në fund gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 90 nenin 35 paragrafi 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për kamatën ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë e pranon në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm, sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqë Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, mirëpo, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron as pretendimi ankimor për shkelje të dispozitave të nenit 182 par.2 pika n) të LPK-së, pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, andaj nuk mund të pranohet pretendimi për shkelje të tilla në raport me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet

se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Po ashtu me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.* Me nenin 35 paragraf 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”.* Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar në tërësi, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit e refuzon si të pabazuar pretendimin ankimor të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruarit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare, pasi që vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura. Në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditëseve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontrate “ 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së

Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruerit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Gjykata me rastin e aplikimit të kamatës ligjore, iu referua nenit 382, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimeve nr.04/L-077, në të cilën parashihet se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën, ndërsa në par.2 të së njëjtit nen parashihet “*Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Në të njëjtën kohë, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka llogaritur dhe i ka pranuar paditëses edhe shpenzimet e procedurës në këtë çështje kontestimore, duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse të njëjtat gjeti se nuk janë me ndikim në vendosje ndryshe nga kjo gjykatë andaj të njëjtat edhe i refuzoi të pa bazuara.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartë cekurave, u në bazë të nenit 195.1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7301/21 , datë 24.08.2023

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka